



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 01.04.2019, ora 11:00

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

Votimi i projektligjit "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 103/2016 "Për akuakulturën"". (*Komision përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Eglantina Gjermani, Rrahman Rraja, Andrea Marto, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Tatiana Nurçe, Robert Bitri, Gjetan Gjetani, Dritan Bici, Arben Pëllumbi, Nimet Musaj, Arlind Çacani, Halil Jakimi dhe Edmond Leka.

Mungojnë:

Lefter Koka.

Të ftuar:

Roland Kristo – zëvendësministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Edlira Llango - përfaqësuese e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

HAPET MBLEDHJA

Niko Peleshi – Mirëdita!

Hapim mbledhjen e Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Në seancën e kaluar kemi bërë dëgjuesën me grupin e interesit, me përfaqësuesit e ministrisë dhe zëvendësministrin.

Kemi përmbyllur seancën e pyetjeve, përgjigjeve, komenteve dhe miratimin në parim. Sot do të bëjmë diskutimin dhe miratimin nen për nen dhe në tërësi të projektligjit “Për akuakulturën”.

Para se të fillojmë me diskutimin zyrtarisht, dua të falënderoj edhe në emrin tuaj deputetin Vullnet Sinaj, i cili mori përgjegjësinë për ta çuar deri në fund zgjidhjen e ngërçit të importit të makinerive bujqësore, përjashtimin nga TVSH-ja. Ishte një ushtrim burokratik sa i thjeshtë, aq edhe i sikletshëm në zbatim, apo në përmbyllje. Tani mendojmë që është përmbyllur me sukses, ka kaluar edhe VKM-ja.

Kalojmë në diskutimin nen për nen të projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 103/2016 “Për akuakulturën”. Mendoj t’i marrim nenet me radhë. Unë kam shënimet përkatëse nga Komisioni i Integritetit, që aktualisht e ka kaluar projektligjin. Ndërkohë, kemi edhe dy vërejtje, që unë i kam mbajtur shënim nga hera e kaluar, për të cilat kemi bërë edhe diskutimin, natyrisht, mund të dalin edhe të tjera sugjerime gjatë diskutimit nen për nen: e para, neni i parafundit, neni 4, i cili bën fjalë për pezullimin, siç përcaktohet në pikën 3 të këtij neni, i cili nuk zbatohet për instalimet, pronën ekzistuese shtetërore të akuakulturës, të trajtohet si dispozitë kalimtare, jo si ndërhyrje në nen.

Po në këtë nen, pika 5 e ligjit bazë, që i referohet neni 4, ku flitet për kriteret e zgjatjes së afatit të kontratave, të shohim mundësinë e riformulimit në mënyrë më eksplicite, pa ekuivok dhe më të qartë.

Fillojmë diskutimin dhe votimin nen për nen.

Neni 1. Kemi një sugjerim nga Komisioni i Integritetit European.

Manjola, çfarë thotë...

(Diskutim pa mikrofon)

E kanë të gjithë anëtarët përpara riformulimin?

Elona, mirë është ta kemi përpara të gjithë raportin e Komisionit të Integritetit, që t'i referohemi nën pas neni.

Ndërkohë, zoti Beqaj ka diçka.

Ilir Beqaj – Kam një merak që e shpreha edhe herën e kaluar, do të doja të gjendej një mënyrë që ose hyrja në fuqi e ZPA-së të bëhet iks muaj nga momenti i miratimit, ose këta që e kanë, të mos u ndërpritet vlefshmëria fiks ditën e miratimit të ZPA-së, por t'u lihet një farë periudhe.

Mund të qëllojë që unë kam filluar një proces, kam investuar dhe ZPA-ja mund të ma ndërpresë, të paktën të më lihet kohë që të mbarojë cikli. Këtë merak kam unë.

Roland Kristo - Mund ta shikojmë kur të bëjmë riformulimin e pikës 5, te neni 4.

Niko Peleshi – Kështu që e diskutojmë aty, se bëhet fjalë për afatet dhe për zgjatjen.

Për nenin 1 ka një rekomandim nga Komisioni i Integritetit për shënimin në fund të faqes. Elona është duke e shpërndarë.

Kush është dakord me riformulimin sipas rekomandimit të Komisionit të Integritetit European? Kundër? Abstenim?

Miratohet neni 1.

Neni 2. Këtu nuk kemi rekomandime.

Kush është dakord sipas riformulimit? Kundër? Abstenim?

Miratohet neni 2 sipas variantit të Këshillit të Ministrave.

Neni 3. Kemi një rekomandim të Komisionit të Integritetit European për pikat 2 dhe 3, kështu që i marrim me radhë.

Neni 3, pika 1. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 3, pika 2. Kush është dakord me riformulimin sipas rekomandimit të Komisionit të Integritetit European?

(Diskutim pa mikrofon)

Riformulimi është: “Kur është e nevojshme në krijimin e organizatës së prodhuesve, duhet të mbahet parasysh gjendja specifike e prodhuesve të vegjël”

Robert Bitri – Te peshkimi është te varianti siç ka ardhur nga Kryeministria, kurse Integriteti e ka sjellë fjalë për fjalë siç e ka Rregullorja.

(Diskutim pa mikrofon)

Niko Peleshi – Pra, jeni dakord me formulimin?

(Diskutim pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Ne themi “Në momentin e njohjes së organizatës prodhuese nga ministri”, kurse ky thotë “në momentin e krijimit të organizatës” dhe e nxjerr fare ministrin.

Roland Kristo - Opsioni që ju ka ardhur nga Kryeministria është riformulimi i bërë te ligji i peshkimit. Pra, “në momentin e njohjes së organizatës”, ky është varianti që është identik si në ligjin e peshkimit.

Ilir Beqaj – Mos është fjala “miratim” në vend të fjalës “njohje”...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Se fjala “njohje” nuk tingëllon fort, si për shembull, në vend të saj të përdorim fjalën “miratim”.

Niko Peleshi – Varet se si e kemi termin edhe në ligj.

Ilir Beqaj – Fjalja fillon kështu: “Kur është e nevojshme ...”

Do ta bëj edhe një herë sqarimin: duke qenë se bëhet fjalë për të njëjtën rregullore që ka hyrë qoftë te ligji i peshkimit, qoftë te ligji i akuakulturës, por në rastin e parë u drejtohet organizatave prodhuese në fushën e peshkimit dhe në rastin e dytë për akuakulturën, kjo pikë u riformulua nga ky komision te ligji i peshkimit. Riformulimin që u bë te ligji i peshkimit e kemi sjellë këtu. Komisioni i Integritetit e ka rikthyer në formatin siç e ka fjalë për fjalë Rregullorja e Bashkimit European. Pra, modifikimi që kërkon Komisioni i Integritetit është siç e ka Rregullorja, por jo siç e ka vendosur ky komision te ligji i peshkimit. Isha i qartë?

(Diskutime pa mikrofon)

Ka dy momente: zëvendëson fjalën “njohje” me fjalën “krijim” ndërkohë, Komisioni i Integritetit e fillon fjalinë kështu: “Kur është e nevojshme...” vazhdojmë njësoj siç e kemi ne.

(Diskutime pa mikrofon)

Roland Kristo – Jo, hiqet fjala “kur është e nevojshme, sepse duhet të jetë taksative në mënyrë që të njihet.

Niko Peleshi – Të lëmë variantin e ardhur nga Kryeministria dhe të mos merret parasysh varianti i Komisionit të Integritetit.

Roland Kristo – Ne duhet ta zbusim pak...

Ilir Beqaj – Unë jam i mendimit që ta homogjenizojmë...

Roland Kristo – Ai variant ka ardhur, ndoshta mund të jetë defekt përkthimi...

Niko Peleshi – Roland, po një variant i ndërmjetëm? Pra, në momentin e krijimit të organizatës prodhuese duhet të kihet parasysh nevojat dhe të hiqet fjala “njohja” dhe të zëvendësohet me fjalën “krijim”, ndërkohë të heqim edhe këtë...

Ilir Beqaj – Ata e krijojnë vetë...

Besnik Baraj – A mund të bëj një koment?

Roland Kristo – Ai mund ta krijojë dhe ti nuk e njeh, ndërsa këtu është në momentin e njohjes, pra ai e ka krijuar dhe ti e njeh...

Besnik Baraj – Nuk e di se çfarë mendojnë ekspertët juristë, por kur thuhet “kur është e nevojshme”, për mua lë shumë për subjektivitet...

Roland Kristo – Nuk është taksativ...

Besnik Baraj - ... ndërsa kur thuhet “në momentin e krijimit” është diçka tjetër. Kur është e nevojshme unë vij te ju dhe ju më thoni: ne kështu e pamë të nevojshme...

Për mua termi “kur është e nevojshme” duhet të hiqet.

(Diskutime pa mikrofon)

Niko Peleshi – Urdhëro, Roland.

Roland Kristo – Unë e kuptoj që termi “kur është e nevojshme”, i nxjerrë nga konteksti krijon të gjitha problemet. Po ju them një situatë, kemi krijimin e organizatave të prodhuesve, të cilat kur është e nevojshme, teorikisht, kjo është logjika e Rregullores së Bashkimit Europian, të marrin në konsideratë edhe gjendjen e prodhuesve të vegjël në mënyrë që të shmanget mundësia e bërjes së një monopoli, pavarësisht faktit se e gjithë rregullorja më pas, kur të miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, e shmang këtë. Fakti qëndron, prandaj edhe shprehja “kur është e nevojshme” është për faktin që të mos krijohet pjesa e monopolit.

Dua t’ju them diçka në lidhje me këtë fakt. Për organizatat e prodhuesve dhe mënyrën se si ato janë të organizuara ekziston rreziku që të krijohet një monopol. Pse? Sepse është vetë në logjikën e tyre, ata do të diskutojnë bashkë dhe do të bien dakord për nivelin e prodhimit, për çmimet në treg dhe për shumë gjëra të tjera. Pra, në këtë mënyrë e gjithë rregullorja dhe të gjitha nenet që vijnë më pas do të shmangin mundësinë e krijimit të monopolit në këtë drejtim dhe për këtë arsye përdoret termi “kur është e nevojshme”, sepse ai e ka të garantuar atë pjesën e vendosjen që ata të bëjnë kartel me njëri-tjetrin. Sa u takon më pas termave juridikë, është histori tjetër.

(Diskutime pa mikrofon)

Sa i takon peshkimit ne e kemi lënë ashtu siç ju ka ardhur ju nga Kryeministria.

(Diskutime pa mikrofon)

Ata duan që ne njësimin e ligjeve ta kemi si ata, por duhet ta marrin parasysh këtë moment, ashtu siç e thotë edhe zëvendësministri. Nuk ka asgjë të keqe që ajo të vihet ashtu siç kërkohet, sepse ata mund ta rregullojnë më mbrapa te nenet e tjera...

Edlira Llango – Sipas meje materiali që ka sjellë Komisioni i Integritetit, si dhe ideja e përshtatjes së legjislacionit tonë me atë të Bashkimit Europian kanë një qëllim në fund fare, moskrijimi i monopolit. Ne këtë gjë kemi parasysh edhe kur bëjmë ligjin për peshkimin, por edhe këtu. Të kapemi vetëm te fjala “kur është e nevojshme”, nuk më duket me sens. Pra, ideja që ne kemi diskutuar është moskrijimi i monopoleve qoftë në ligjin e peshkimit dhe atë të akuakulturës...

Niko Peleshi - A do të kenë një rregullore, e cila do të miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave?

Edlira Llango – Po.

Niko Peleshi - Atëherë, pse mos ta lëmë termin “kur është e nevojshme” dhe më pas ta specifikojmë më qartësisht në rregullore?

Roland Kristo – A mund të bëj një sqarim?

Niko Peleshi – Po.

Roland Kristo – 1379 do të ketë të gjitha rregullat se çfarë quhet organizatë e prodhuesve dhe si të shmanget e gjithë mundësia që ata të vendosin çmimet dhe kjo miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Ne kemi marrë vetëm një pjesë të vogël...

Niko Peleshi – E gjithë çështja qëndron në faktin që kështu siç duket në ligj është me ekuivok dhe lë vend për interpretim. Në qoftë se do të ketë një rregullore ku do të specifikohet qartë se çfarë nënkuptohet me termin “kur është e nevojshme”, atëherë mund ta kalojmë në këtë formë dhe jemi në rregull edhe me Bashkimin Europian.

Gjetan Gjetani – Zoti kryetar, edhe unë këtë mendim kam. Sa i takon konkurrencës, në qoftë se ka më shumë se 2-3 persona që bëjnë biznes, atëherë ata bëjnë konkurrencë me njëri-tjetrin dhe këtë nuk mund ta quash monopol. Nëse ne bëjmë këtë analizë, kjo punë mund t'i ndodhë çdo biznesi, sepse është vetë tregu ai që e imponon.

Niko Peleshi – Unë mendoj se është më mirë të bëhet VKM dhe në këtë mënyrë qartësohet dhe shmangen ekuivoket.

Roland Kristo – Ne e pranuan këtë fakt edhe kur ishim në Komisionin e Integritetit dhe nuk shoh ndonjë rrezik.

Niko Peleshi – Hedhim në votë pikën 2 të nenit 3 të riformuluar, sipas rekomandimit të bërë nga ana e Komisionit të Integritetit Europian. Kush është pro? Kundër? 1 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet pika 2 e nenit 3, sipas formulimit që ka bërë Komisioni i Integritetit Europian.

Pika 3. Edhe për këtë pikë kemi një rekomandim nga ana e Komisionit të Integritetit Europian. Pas fjalës “akuakulturës” është shtuar fjala “dhe të peshkimit”. Kjo pikë është formuluar në këtë mënyrë: “Një organizatë e prodhuesve që përfaqëson aktivitetet e akuakulturës dhe të peshkimit, të krijohet si organizatë e përbashkët e prodhuesve në sektorët e peshkimit dhe të akuakulturës”.

(Diskutime pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Unë nuk jam dakord, sepse disa bashkohen vetëm për akuakulturën, por kështu siç është formuluar me fjalën “dhe” bëhet në mënyrë që të jetë edhe për akuakulturën dhe për peshkimin dhe ju lind e drejta të bashkohen. Fjala “dhe” që është vendosur aty e ka përforcuar disi këtë gjë...

Person – Fjala “dhe”, që është vendosur aty, e detyron...

Niko Peleshi – Unë e kuptoj në këtë mënyrë, në qoftë se ka ndonjë organizatë, e cila i ka të dyja atëherë krijohet si organizatë e prodhuesve...

Ilir Beqaj – Po të ketë vetëm njërin? Nuk krijohet.

Niko Peleshi – Jo, krijohet si organizatë akuakulture nëse ka vetëm njërin. Nëse ka vetëm peshkimin, krijohet si organizatë peshkimi. Në qoftë se i ka të dyja, krijohet si organizatë e përbashkët e prodhuesve të peshkimit dhe të akuakulturës. Roland, ky është interpretimi?

Roland Kristo – Po, ky është.

Ilir Beqaj – Në gjysmën e dytë të fjalisë thuhet: “Si organizatë e përbashkët e prodhuesve në sektorët e peshkimit dhe të akuakulturës”.

Niko Peleshi – Fjala kyçe është “e përbashkët”...

Ilir Beqaj – E përbashkët e prodhuesve dhe jo e sektorëve. Fjala “e përbashkët” mbledh prodhuesit në kooperativë dhe nuk kooperativizon akuakulturën me peshkim, sepse ajo është e përbashkët për ata që punojnë bashkë dhe jo për dy nënsektorë.

Niko Peleshi – Është me “dhe”. Pra, është në këtë mënyrë: “dhe në sektorët e peshkimit dhe të akuakulturës”.

Ilir Beqaj – Po, sepse sektorët janë të tillë.

Robert Bitri – Ai do që mos t’i pengojë, në qoftë se dy sektorët duan të bashkohen. Pra, të lejohet që të mos jenë veç e veç...

Ilir Beqaj – Berti, jemi te ligji i akuakulturës, ndërsa peshkimi është tjetër. Ndryshe i bashkonim të dyja ligjet bashkë dhe i administronim...

Robert Bitri – Kjo gjë duhet të plotësohet, sepse në momente të caktuara si bazë është akuakultura, por zhvillohet edhe peshkimi, ose vjen një organizatë e vogël dhe bashkohet me ta...

Ilir Beqaj – Por ata që kanë vetëm një, nuk bashkohen dot dhe ky është merakë që unë kam...

Niko Peleshi – Kam përshtypjen se i gjithë problemi qëndron te fjala “e përbashkët”. Kam përshtypjen se sipas këtij ligji kuptimi i fjalës “e përbashkët” është për dy nënsektorët...

Ilir Beqaj – Ato janë dy ligje të ndryshme dhe nuk mund të bashkohen në një ligj.

Niko Peleshi – Ky është kuptimi i ligjit.

Roland Kristo – Pikërisht, prandaj fjalën “dhe peshkimit” na e hoqi një nga ministrinë e linjës vetëm për faktin se janë dy ligje të veçanta, por kjo nuk do thotë se pavarësisht që janë dy sektorë të ndryshëm, me peshkun merren të dyja.

Çfarë është një organizatë e përbashkët?

Zëvendësministri - Një organizatë e përbashkët bashkon prodhuesit, ata që sjellin ushqimin, ata që e shesin.

Niko Peleshi - Një organizatë e përbashkët bashkon dy nënsektorë, peshkimin dhe akuakulturën, apo bashkohen brenda një nënsektori të gjithë prodhuesit?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Nuk jam dakord me atë që thoni, zoti zëvendësministër.

Roland Kristo – Termi “organizatë e prodhuesve” është një term më i gjerë. Organizata e prodhuesve është një nga sektorët që mbështetet shumë nga BE-ja. Cili është qëllimi? Qëllimi është që oferta me tregun të jenë në ekuilibër. Në këtë mes që nga prodhuesi e deri te shitësi

fundor përfshihen bashkë, pra kjo është ndryshe nga organizata e menaxhimit ose nga organizatat e tjera. Organizata e prodhuesve i përfshin të gjitha hallkat e zinxhirit.

Ilir Beqaj – Shqetësimi im është nëse duhet të bashkohen bashkë në një organizatë vetëm disa që merren me akuakulturë? Sepse pastaj mund t'i thonë nuk keni edhe peshkim, prandaj nuk bëheni dot bashkë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Në pikën 1 flitet për organizatat e prodhuesve të akuakulturës. Pastaj kemi pikën 2, që ka të bëjë me njohjen nga ministri, dhe pikën 3 në të cilën flitet për rastet e organizatave mikse që kanë edhe akuakulturë, edhe peshkim. Këtu krijohet hapësira e krijimit të këtyre organizatave, pra një organizatë që bashkon prodhues të akuakulturës, por edhe të peshkimit, pra hap mundësinë e krijimit të organizatave mikse. Një organizatë mikse do të duhet të mbështetet në dy ligje, të peshkimit dhe akuakulturës.

Ilir Beqaj - Atëherë duhet që pika 2 të ndërrohet me pikën 3, sepse i bie që 3 të mos njihet nga ministri.

Niko Peleshi - Po, kjo është e drejtë.

Ilir Beqaj – Madje duhet thënë: “organizatat e krijuara sipas pikës 1 ose pikës 2”.

Niko Peleshi- Dakord.

Hedhim në votim nenin 3 sipas formulimit të Komisionit të Integritetit Europian: “Një organizatë e prodhuesve, që përfaqëson aktivitete të akuakulturës dhe të peshkimit, të krijohet si organizatë e përbashkët e prodhuesve në sektorin e peshkimit dhe akuakulturës”.

Kjo është pika 3 të bëhet pika 2 e nenit 3.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Atëherë, e hedhim edhe një herë në votim pikën 2 për ta bërë pikën 3 të nenit 3, siç ramë dakord, duke marrë parasysh edhe rekomandimin e Komisionit të Integritetit Europian. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Votojmë në tërësi nenin 3. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Bëmë votim në tërësi, por ishte e gabuar, sepse nuk ka përfunduar neni 3.

Manjola, a mund të votojmë në tërësi ndryshimet e nenit 44/1?

Manjola Merlika- Po.

Niko Peleshi – Atëherë, po e përsëris edhe një herë, kush është dakord me votimin në tërësi të ndryshimit të nenit 44/1? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Kalojmë tani brenda nenit 3 te blloku tjetër. Janë ndryshimet e nenit 44/2 “Objektivat e organizatave të prodhuesve”. Te pika 3 kemi një rekomandim, por po i marrim me radhë pikat.

Pika 1 e këtij neni. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Pika 2. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Edlira Llango - Te pika 2, përveç objektivave të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni aktualisht është “organizata prodhuese”, të bëhet “organizata e prodhuesve”.

Niko Peleshi - Dakord. Atëherë, neni 2 të miratohet me këtë saktësim. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Niko Peleshi – Pika 2 e nenit 42/2 të nenit 3. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me këtë saktësim.

Jemi te pika 3. Këtu kemi një rekomandim nga Komisioni i Integritetit Europian.

Ilir Beqaj – Ne themi “objektivat plotësues”, ndërsa ata thonë “objektiva të tjerë plotësues”, pra nëse janë plotësues, të tjerë janë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Edhe unë kështu mendoj. Për konformizëm të padëmshëm...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Dakord, por për dhënie mendimi janë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Mos u referohen ndonjë rregulloreje?

Ilir Beqaj – Le t’i referohen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe një herë janë dy terma “objektiva plotësues” dhe “objektiva të tjerë plotësues”, pra është tepricë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Po, është hequr fjala “objektiva” nga dy fjalitë, pra “objektivave plotësues” dhe “objektivave të mësipërm” dhe është përmbledhur në “objektivave të tjerë plotësues”.

Ilir Beqaj – Besnik, nëse është kështu, unë jam dakord me ty, por mendoj ta heqim fare pikën 3 dhe të shtojmë një germë “e”, ku të jenë “objektiva të tjerë plotësues”. Logjikisht shkon, te neni 2, shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d” dhe “e” dhe nuk kemi një pikë të re.

Niko Peleshi – Manjola dhe Xhilda, si mendoni?

Edlira Llango – Pikat 2 dhe 3 ne i shohim të ndara. Pika 2 thotë: “Përveç objektivave që janë në pikën 1”. Pra, pika 2 të jep mundësi të zgjedhësh dy prej pesë objektivave që janë në këtë pikë, ndërsa pika 3 të jep mundësi të zgjedhësh edhe të tjera.

Ilir Beqaj – Atë çfarë duan?

Edlira Llango – Të tjera plotësuese të këtyre objektivave, prandaj është fjala “plotësues”

Ilir Beqaj – Po të kujt?

Edlira Llango – Të objektivave që janë më sipër.

Ilir Beqaj – Atëherë i bie që jetë “dhe të tjerë plotësues”.

Niko Peleshi – Jo, sepse janë dy pika, pika 1 dhe pika 2.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kush është dakord me formulimin e pikës 3, sipas rekomandimit të Komisionit të Integritetit Europian, konkretisht: “Organizatat prodhuese mund të ndjekin objektiva të tjerë plotësues”? Kundër? Nuk ka. Abstenim? 1 votë.

Miratohet.

Hedhim në votim nenin 44/2, pjesë e nenit 3. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Hedhim në votim në tërësi nenin 3. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 4. Këtu kemi pasur një diskutim nëse duhet të ndërhyjmë në ndryshimin e nenit 50 apo duhet ta trajtojmë si dispozitë kalimtare.

Përfaqësuesit e ministrisë, a kanë ndonjë mendim?

Edlira Llango – E kemi lënë në vlerësimin tuaj.

Niko Peleshi – Ne a kemi ndonjë mendim tjetër? Jo.

Dakord e hedhim në votim.

Kush është dakord që neni 50, pjesë e nenit 4, të jetë dispozitë kalimtare dhe jo ndryshuese?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në pikat 4 dhe 5 të nenit 4.

Pika 4 ka të bëjë me pezullimin e përcaktuar në pikën 3 të nenit që nuk zbatohet për instalimet, pronë ekzistuese shtetërore të akuakulturës.

A ka ndonjë mendim nga përfaqësuesit e ministrisë?

Edlira Llango – Nëse do ta lëmë dispozitë kalimtare, atëherë mbase duhet specifikuar: “Pezullimi i përcaktuar në pikën 3 të nenit 50 nuk zbatohet për instalimet pronë ekzistuese”.

Niko Peleshi – Është e vërtetë, nuk mund të trajtohet si pikë më vete, pra si pika 4, sepse ky ishte kuptimi i dispozitës kalimtare.

A mund të bëni një riformulim?

Edlira Llango – “Pezullimi i përcaktuar në pikën 3 të nenit 50 nuk zbatohet për instalimet pronë ekzistuese shtetërore të akuakulturës”.

Niko Peleshi – Kush është dakord me këtë riformulim? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Pika 5 është bërë sipas variantit të propozuar nga Këshilli i Ministrave, konkretisht: “Kontratat e lidhura përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, të cilave u mbaron afati përpara miratimit të ZPA-së, konsiderohen të vlefshme deri në miratimin e ZPA-së”. Kjo është pjesa e parë.

Pjesa e dytë e këtij paragrafi lidhet me zgjatjen e afatit të këtyre kontratave deri në miratimin e ZPA-së, e cila do të bëhet me kërkesë të ushtruesit të veprimtarisë së akuakulturës. Kërkesa për zgjatjen e afatit të kontratës refuzohet në rastet e parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç” dhe “d” të pikës 2 të nenit 25 të ligjit.

Këtu besoj se duhet të integrojmë mendimet dhe diskutimet për përcaktimin më mirë të kritereve, por edhe propozimin për vendosjen e një afati për operatorët, të cilëve do t'u ndërpritet kontrata.

Si e mendoni?

Besnik Baraj – Këtu kemi bërë edhe një koment në lidhje me një paradoks në dukje, pra nga njëra anë thuhet që automatikisht miratohet dhe nga ana tjetër vendoset një kusht, prandaj ndoshta duhet të lehtësohen.

Roland Kristo – Ne kemi punuar dhe kemi sjellë një përkufizim, si për pjesën e miratimit automatik, por edhe atë të kushteve.

Zonja mund ta lexojë nëse është në përputhje.

Edlira Ilango – “Kontratat e lidhura përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, të cilave u mbaron afati përpara miratimit të ZPA-së konsiderohen të vlefshme deri në miratimin e ZPA-së, nëse paraqitet kërkesë nga ushtruesi i veprimtarisë së akuakulturës. Kërkesa për zgjatjen e afatit të kontratës refuzohet në rastet e parashikuara në germa “a”, “b”, “ç” dhe “d”, të pikës 2, të nenit 25, të ligjit”.

Niko Peleshi - Pra, si vazhdon më pas fjalia “...deri në miratimin e ZPA-së”?

Edlira Llango – Fjalia vazhdon: “...deri në miratimin e ZPA-së, nëse paraqitet kërkesë nga ushtruesi i veprimtarisë së akuakulturës”. Më pas do të heqim fjalinë e dytë dhe vazhdon: “Kërkesa për zgjatjen e afatit të kontratës refuzohet në rastet e parashikuara në germa “a”, “b”, “ç” dhe “d”, të pikës 2, të nenit 25, të ligjit”. Megjithatë, duke u nisur edhe nga diskutimi i radhës së kaluar...

Roland Kristo – Lidhur me germën “d”, në qoftë se e kanë ndërprerë ose jo, teorikisht duhet ta ketë ndërprerë këtë pjesë, edhe pse ne mund t'i kemi toleruar. Germa “d” është që nuk rinovohet vetëm në rast se ushtruesi i veprimtarisë e ka ndërprerë aktivitetin.

Ideja është që në qoftë se ushtruesi i veprimtarisë e kërkon dhe në qoftë se nuk ka shkelur asnjë pikë të ligjit, atij automatikisht t'i rinovohet.

Ilir Beqaj – Jo automatikisht, por duhet ta kërkojë.

Roland Kristo – Automatikisht, sipas kërkesës së bërë dhe ideja është në rast se ai e kërkon dhe këtë gjë e lexuam.

Pikërisht, në qoftë se ai e ka mbyllur aktivitetin e tij dhe nuk ka bërë kërkesë, automatikisht bie germa “d”.

(Diskutime pa mikrofon.)

Roland Kristo – Natyrisht, këtu do të integrojmë edhe propozimin e zotit Beqaj për punën e ciklit.

Niko Peleshi - Si do të integrohet kjo?

Roland Kristo – Me miratimin e ZPA-së, me vendim të Këshillit të Ministrave, afati i kontratës nuk mund të jetë më shumë se 18 muaj.

(Diskutime pa mikrofon.)

Niko Peleshi – Zonja Bode, si do të riformulohet?

Edlira Llango – Në fakt, këtë propozim e bëmë tani që kontrata mund të vazhdojë edhe pas miratimit të ZPA-së deri në plotësimin e ciklit.

Roland Kristo – Por, jo më shumë se 18 muaj dhe kështu kuptohet.

Shqetësimi im qëndron në qoftë se unë them një cikël, ai mund të më thotë: “Prit se unë tani hodha disa të tjera dhe cikli mund të më shtyhet”. Pra, maksimumi i ciklit duhet të jetë 18 muaj.

Edlira Llango – Këtë gjë mund ta vendosim direkt këtu: “E vlefshme deri në 18 muaj, pas miratimit të ZPA-së”.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ose mund ta lexojmë të gjithë fjalinë e parë: “Kontratat e lidhura përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, të cilave u mbaron afati përpara miratimit të ZPA-së, konsiderohen të vlefshme deri 18 muaj pas miratimit të ZPA-së, nëse paraqitet kërkesë nga ushtruesi i veprimtarisë së akuakulturës”.

Niko Peleshi - Jo, sepse e kufizon!

Unë mendoj se duhet ta vendosim si pikë të tretë të nenit. Pra: “Kontrata do të vazhdojë maksimumi 18 muaj”.

Roland Kristo – Ndoshta mund të themi edhe qëllimin pse jepet ky 18 muajsh.

Niko Peleshi – Mund ta lidhim me ciklin dhe ta formulojmë siç tha zoti Bitri.

Roland Kristo – Me qëllim përfundimin e ciklit.

Niko Peleshi – Pra, ta bëjmë: “...deri në përfundimin e ciklit, por jo më shumë se 18 muaj”.

(Diskutime pa mikrofon.)

Megjithatë, mendoj se duhet ta mbyllim pikën 2, sepse kjo do të kalojë te pika 3. Zonja Edlira më korrigjoni nëse e kam gabim!

Pika 2 e riformuluar do të jetë kështu: “Kontratat e lidhura përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, të cilave u mbaron afati përpara miratimit të ZPA-së, konsiderohen të vlefshme deri 18 muaj, pas miratimit të ZPA-së, nëse paraqitet kërkesë nga ushtruesi i veprimtarisë së akuakulturës”. Me tej do të vazhdojë: “Kërkesa për zgjatjen e afatit të kontratës refuzohet në rastet e parashikuara në shkronjat “a”, “b” dhe “ç, të pikës 2, të nenit 25, të ligjit”. Pra, ky është neni 2 i riformuluar.

Kush është dakord me këtë riformulim?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Tani do të ndërtojmë pikën 3, e cila, sipas propozimit të zotit Bitri, do të jetë kështu: “Kontratat e lidhura, para hyrjes në fuqi të këtij ligji, sipas pikës 2 të këtij neni, do të vazhdojnë aktivitetin deri në përfundimin e ciklit të prodhimit, por jo më shumë se 18 muaj”. Natyrisht, kjo do të riformulohet më të saktë nga shërbimi i komisionit, por kjo është përmbajtja në thelb.

Kush është dakord që ta shtojmë këtë pikë me këtë përmbajtje?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Atëherë, hedhim në votim në tërësi nenin 4 si dispozitë kalimtare.

Kush është dakord?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 5. “Hyrja në fuqi”: “Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare”.

Kush është dakord me nenin 5?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 103/2016 “Për akuakulturën””.

Kush është dakord me projektligjin?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në tërësi projektligji.

I uroj punë të mbarë ministrisë!
Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA